



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.34**

**28 mars**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.135, datë 14.3.2007	Për krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve.....	653
Vendim i KM nr.138, datë 14.3.2007	Për procedurën e trajtimit të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi...	564
Vendim i KM nr.139, datë 14.3.2007	Për kufijtë e përcaktimit të pagës në natyrë dhe kriteret e përlllogaritjes së shpërblimit, që i shtohet pagës për leje vjetore...	656
Vendim i KM nr.146, datë 28.3.2007	Për shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”.....	657

**VENDIM**  
**Nr.135, datë 14.3.2007**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË QENDRORE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË  
NXËNËSVE DHE PËR SHKRIRJEN E QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË  
VLERËSIMIT DHE TË PROVIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, AVA, si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve.

2. Objekti i AVA-së është vlerësimi i arritjeve të nxënësve, nëpërmjet provimeve kombëtare dhe vlerësimit të jashtëm, me kampionim, me anë të të cilit testohen dhe vlerësohen arritjet e një grupi pilot nxënësish.

3. AVA-ja ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, dhe ka për detyrë:

a) të kontribuojë në hartimin e politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave;

b) të hartojë testet e provimeve kombëtare shkollore dhe të drejtojë menaxhimin e provimeve;

c) të hartojë testet e vlerësimeve të jashtme kombëtare, me kampionim, të arritjeve të nxënësve (më poshtë: Vlerësime) dhe të drejtojë menaxhimin e vlerësimeve;

ç) të analizojë dhe interpretojë, sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të grupeve të interesit, rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve;

d) të përgatisë ose drejtojë përgatitjen e personelit, që përfshihet në provimet kombëtare dhe vlerësimet;

dh) të krijojë dhe përditësojë një bazë të dhënash për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet;

e) të përpunojë të dhënat shkollore dhe të maturës shtetërore, për pranimin e studentëve në shkollat e larta të vendit;

ë) të hartojë e botojë raporte për provimet kombëtare dhe vlerësimet me kampionim, për:

- politikëbërësit, vendimmarrësit, profesionistët arsimorë;

- institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe grupet e interesit;

f) të mbështesë procesin e hartimit dhe të përdorimit të testeve të standardizuara lëndore në ndihmë të mësuesve, inspektorëve dhe drejtuesve të shkollave;

g) të marrë pjesë në trajnimin e drejtorëve të shkollave, inspektorëve dhe mësuesve, për përdorimin e testeve lëndore të standardizuara dhe përpunimin e interpretimin e arritjeve të nxënësve në to;

gj) të jetë zbatuese e testimeve ndërkombëtare, për arritjet e nxënësve, ku merr pjesë Shqipëria;

h) të hartojë çdo vit një raport për nevojat profesionale të mësuesve, të mbështetur në arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe në vlerësimet;

i) të përpunojë të dhënat për provimet përfundimtare të mësuesve për shkallët e karrierës, kur një gjë e tillë i kërkohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

j) të bashkëhartojë dhe nënshkruajë dokumentin vjetor të bashkëpunimit me Institutin e Kurrikulave dhe të Standardeve dhe me Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsim;

k) të kontribuojë në hartimin e rregulloreve të provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve.

4. Struktura dhe organika e AVA-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

5. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton:

a) Statutin dhe rregulloren e funksionimit të AVA-së;

b) Përbërjen e bordit këshillimor të AVA-së.

6. Drejtuesi i AVA-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AVA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Pagat e drejtuesve dhe të nëpunësve të AVA-së caktohen në bazë të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

9. Numri i punonjësve të AVA-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

10. Për punonjësit, që pas riorganizimit humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

11. AVA-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

12. Vendimi nr.309, datë 12.5.2001 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve", i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

#### **VENDIM**

**Nr.138, datë 14.3.2007**

### **PËR PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË HEQURA NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

Për trajtimin e armëve, të teknikës, pajisjeve dhe municioneve të Forcave të Armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi, të zbatohen këto procedura:

I. Për armët, teknikën, pajisjet, municionet, lëndët eksplozive të Forcave të Armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi, që do të shiten për përdorim ushtarak.

1. Pas heqjes nga armatimi e përdorimi, armët, teknika, pajisjet, municionet dhe lëndët eksplozive të Forcave të Armatosura u nënshtrohen vlerësimit dhe përcaktimit të çmimit të tyre për shitje. Në Ministrinë e Mbrojtjes, me urdhër të ministrit, krijohet komisioni i miratimit të çmimeve, me ekspertë të fushave përkatëse të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ekspertë të financës, juristë, ekonomistë e të tjerë.

2. Shitja e armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive të Forcave të Armatosura realizohet nëpërmjet ndërmarrjes MEICO, e cila zbaton çmimet e miratuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Armët, teknika, pajisjet, municionet dhe lëndët eksplozive, të kërkuara për përdorim ushtarak, pas negociemeve i shiten kërkuesit më të parë, duke realizuar një çmim sa më të lartë, por jo më të ulët se çmimi i miratuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Blerësi duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë i licencuar në këtë fushë në vendin e origjinës;

b) Të paraqesë deklarin e përdoruesit të fundit ose një dokument tjetër lejues për import, nga autoriteti i vendit importues.

5. Lejet për eksportin e armëve, të teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve plasëse lëshohen nga Ministria e Mbrojtjes. Për lëshimin e tyre respektohen parimet e kodit të sjelljes të Bashkimit Europian për eksportin e armëve, miratuar me vendimin nr.604, datë 28.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin, në parim, të kodit të sjelljes së Bashkimit Europian për eksportin e armëve".

6. Kësaj procedure i nënshtrohet edhe shitja e pjesëve të këmbimit të armëve.

II. Për armët, teknikën, pajisjet, municionet, lëndët eksplozive të Forcave të Armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi, që do të shiten jo për përdorim ushtarak.

1. Pas heqjes nga armatimi e përdorimi, armët, teknika, pajisjet dhe municionet e Forcave të Armatosura mund të shiten për qëllime muzeale, koleksioni apo për përdorim tjetër civil, vetëm pasi të çmilitarizohen (bëhen të paefektshme si armë). Procedurat e çmilitarizimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes dhe udhëzim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Çmimi për armët, teknikën, pajisjet e Forcave të Armatosura, që mund të shiten për qëllime muzeale, koleksioni apo për përdorim tjetër civil përcaktohet nga komisioni i miratimit të çmimeve, në Ministrinë e Mbrojtjes, pas çmilitarizimit të tyre.

3. Shitja e armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive të Forcave të Armatosura realizohet nëpërmjet ndërmarrjes MEICO, e cila zbaton çmimet e vendosura nga komisioni i miratimit të çmimeve e të miratuara në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Këto produkte, pas negociemeve, i shiten kërkuesit më të parë, duke realizuar një çmim jo më të ulët se çmimi i miratuar.

5. Blerësi duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë i regjistruar pranë autoritetit shtetëror të kontrollit të import-eksportit të mallrave ushtarake e atyre me përdorim të dyfishtë në vendin e origjinës si importues, eksportues apo ndërmjetësues, duke paraqitur dokumentin përkatës zyrtar.

b) Të paraqesë deklarin e përdoruesit të fundit ose një dokument tjetër lejues për import nga autoriteti shtetëror i kontrollit të import-eksportit të mallrave ushtarake e atyre me përdorim të dyfishtë të vendit të importuesit.

6. Leja për eksportin e mallrave, e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes.

III. Për armët, teknikën, pajisjet e Forcave të Armatosura të hequra nga armatimi dhe përdorimi, që do të shiten për skrap

Kur armët, teknika, pajisjet e Forcave të Armatosura nuk mund të shiten për qëllime, ushtarake ose joushtarake, ato i nënshtrohen procesit të çmilitarizimit dhe çmontimit dhe të shiten për skrap, me ankand.

IV. Shitja për çmontim dhe çmilitarizim i municioneve

1. Ministria e Mbrojtjes, në funksion të reduktimit të stokeve të vjetëruara të municioneve të kalibrit të vogël, të nxjerra nga përdorimi e armatimi, mund të realizojë shitje për qëllim çmontimi dhe çmilitarizimi. Ky proces përfshin shitjen e municionit, mbikëqyrjen e procesit të çmilitarizimit dhe çmontimit të municioneve dhe të nënprodukteve, të rrjedhura prej tyre.

2. Komisioni i miratimit të çmimeve, në Ministrinë e Mbrojtjes, përcakton çmimin për shitjen e municioneve për çmontim dhe çmilitarizim. Në përcaktimin e çmimit për këtë kategori municionesh komisioni mban parasysh edhe koston për çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve për elemente të tilla, si investimi, kosto faktike e punës së bërë, metoda e përdorur, ndikimi në mjedis etj, si dhe vlerën e nënprodukteve të përfutuara nga çmontimi e çmilitarizimi i municionit.

3. Procedurat e shitjes së municionit për çmontim dhe çmilitarizim kryhen nga ndërmarrja MEICO, në bazë të kontratave. Në lidhjen e kontratave me subjekte të ndryshme të mbahen

parasysh: përvoja e ofertuesit në fushën e armatim-municioneve, kapacitetet teknike, lloji i teknologjisë së përdorur në procesin e çmilitarizimit e çmontimit, afatet, ndikimi në mjedis, respektimi i masave të sigurisë gjatë procesit të çmilitarizimit e të çmontimit dhe çmimet e miratuara në pikën 2 të këtij kreu.

4. Procesi i çmilitarizimit e çmontimit të kryhet nën mbikëqyrjen dhe sigurinë ushtarake të reparteve të Forcave të Armatosura, duke regjistruar me hollësi të dhëna për regjimin, lëvizjen dhe sasinë e municioneve të dorëzuara dhe të atyre të çmontuara e të çmilitarizuara, si dhe të produkteve të tyre, pas çmontimit dhe çmilitarizimit.

V. Lëndët eksplozive dhe plasëse të Forcave të Armatosura, të hequra nga aramtimi dhe përdorimi, që nuk kanë asnjë vlerë tregu dhe përdorimi, asgjësohen, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materialeve monetare", të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji.

VI. Shitja e pjesëve të këmbimit të teknikës dhe i pajisjeve i nënshtrohet ankandit.

VII. Ministri i Mbrojtjes, nëpërmjet një komisioni të posaçëm, përcakton kategorizimin e kontingjentit të armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive, të hequra nga armatimi e përdorimi, sipas qëllimit të trajtimit, të përcaktuara në kërret I, II, III, IV, V, duke pasur parasysh kohën e prodhimit, gjendjen faktike të tyre, kërkesat e tregut dhe leverdinë ekonomike. Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet me rregullore, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.

VIII. Ministria e Mbrojtjes mund të lidhë marrëveshje teknike ndërkombëtare me subjekte shtetërore apo donatorë të ndryshëm, të cilët investojnë për shkatërrimin dhe asgjësimin e armëve e të municioneve stoqe, të trashëguara nga e kaluara e të hequra nga përdorimi e armatimi.

IX. Ministria e Mbrojtjes mund të asgjësojë e të shkatërrojë edhe nëpërmjet strukturave të veta armë, teknikë, pajisje, municione, lëndë eksplozive, të nxjerra nga armatimi dhe përdorimi, me fondet buxhetore, të vëna në dispozicion, si dhe me fonde të donatorëve.

X. Të ardhurat që do të krijohen, të trajtohen në përputhje me vendimin nr.432, datë 26.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

XI. Masa e përfitimit të ndërmarrjes MEICO, për kryerjen e procedurave të shitjes, në interes të Ministrisë së Mbrojtjes, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Financave.

XII. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

## VENDIM

Nr.139, datë 14.3.2007

### **PËR KUFIJTË E PËRCAKTIMIT TË PAGËS NË NATYRË DHE KRITERET E PËRLLOGARITJES SË SHPËRBLIMIT, QË I SHTOHET PAGËS PËR LEJE VJETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 70, 94 e 118 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Punëdhënësit, të cilët, për arsye të kushteve apo të organizimit të punës, nuk mund të sigurojnë lokal për ngrënie, me kushte higjienike të pranueshme, sipas lejes së punës, dhënë nga Inpektorati Shtetëror i Punës, duhet t'i kompensojnë punëmarrësit në formën e pagës në natyrë, në masën nga 300 (tre qind) deri 500 (pesë qind) lekë për ditë-punë, dhe, kur trajtohet vetëm me një vakt ushqimi, në masën nga 150 (njëqind e pesëdhjetë) deri në 200 (dyqind) lekë, për ditë-punë.

2. Paga në natyrë përcaktohet në kontratën, kolektive apo individuale, të punës. Në kontratën kolektive apo individuale të punës, palët mund të përcaktojnë edhe trajtime të tjera, si dhe ndryshimin e kufijve të pagës në natyrë, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

3. Shpërblimi, që i përgjigjet pjesës së pagës së përfituar në natyrë, në rastet e llogaritjes së pagës së lejes vjetore, përllogaritet si raport i ditëve të punës, gjatë të cilave punëmarrësi ka përfituar pagë në natyrë me numrin e përgjithshëm të ditëve, gjatë të cilave ka punuar, shumëzuar, me ditët e lejes vjetore dhe pagën ditore në natyrë, të përcaktuara në kontratën, kolektive apo individuale, të punës.

4. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.146, datë 28.3.2007**

**PËR SHKRIRJEN E INSTITUTIT TË INFORMATIKËS DHE MATEMATIKËS SË  
APLIKUAR DHE RIORGANIZIMIN E TIJ, SI PJESË PËRBËRËSE E UNIVERSITETIT  
POLITEKNIK TË TIRANËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.440, DATË  
16.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË  
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I  
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AKADEMISË SË SHKENCAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” të ndryshuar, të neneve 10, 13 e 15 shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shkrirjen e Institutit të Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar (INIMA) dhe riorganizimin e tij, si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës.

2. Numri i punonjësve, fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2007, vlerat materiale, mjetet e inventarit dhe bilanci kontabël i INIMA-s i transferohen Universitetit Politeknik të Tiranës.

3. Mjediset (truall, ndërtesë), në përdorim të INIMA-s dhe në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave.

4. Objekti me numër rendor 1, në formularin, që i bashkëlidhet vendimit nr.440, datë 16.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”, të hiqet nga kjo listë.

5. Ngarkohet INIMA të mbyllë të gjitha procedurat me të tretët, në rastet e kontratave të qiradhënies së mjediseve të saj.

6. Ngarkohet INIMA, që të marrë të gjitha masat për lirimin e menjëhershëm të njërit prej kateve të ndërtesës dhe, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit, për lirimin e kateve të tjera të saj.

7. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
  - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
  - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600**
  - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
  - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

### **Botime të reja**

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 28.3.2007  
 Doli nga shtypi më 28.3.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”  
 Tiranë, 2007

Çmimi 8 lekë